



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

Në mbështetje të nenit 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Nr. 03/L-244);

Duke pasur parasysh standardet dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të cilat në mënyrë të veçantë i garantojnë secilit parimin e barazisë para ligjit, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj;

Duke u bazuar në Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Pushtetit Gjyqësor, të aprovuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në nëntor 1985 si dhe në udhëzimet mbi rolin e prokurorëve të adoptuar nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e të Pandehurve;

Duke u bazuar në Rekomandimin (19) 00 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar shteteve anëtare mbi rolin e prokurorëve në sistemin penal të drejtësisë;

Duke njohur rolin thelbësor që luan Këshilli Prokurorial i Kosovës në sigurimin se të gjithë kanë qasje në drejtësi duke siguruar se prokurori i shtetit është i pavarur, profesional dhe i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore;

Duke qenë në pajtim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, me të cilën anëtarëve të një Këshilli Prokurorial u garantohet liria e shprehjes, besimit, mbledhjes dhe organizimit si çdo qytetari tjetër, megjithatë, gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, anëtari i një Këshilli Prokurorial duhet gjithmonë të sillet në atë mënyrë që të mbrojë dinjitetin e zyrës së tij/saj, si dhe paanshinë dhe pavarësinë e sistemit prokurorial;

Duke pasur parasysh se parimi i ndarjes së pushtetit duhet të respektohet në lidhje me detyrat e Këshillit Prokurorial dhe që me aktivitet e jashtë Këshillit, roli i anëtarit është që të sigurojë që të respektohet roli i gjykatës në mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

Duke pasur parasysh se sjellja e duhur etike dhe perceptimit i sjelljes së duhur etike janë esenciale për performancën e të gjitha aktiviteteve të Anëtarëve të Këshillit Prokurorial, Këshilli Prokurorial i Kosovës miraton:

KODIN E ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR ANETARËT E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Neni 1 Qëllimi

Ky Kod përkufizon standardet vijuese të etikës dhe sjelljes profesionale që duhet të zbatohen nga anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Shkelja e këtij Kodi përbën bazën për sanksionim, në pajtim me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe vlen për të gjithë anëtarët e Këshillit.

Neni 2 Parimet e përgjithshme

1. Format specifike të sjelljes së pahijshme të përshkruara në këtë Kod nuk janë gjithëpërfshirëse. Çdo sjellje e pahijshme apo veprim i ndërmarrë nga anëtari i Këshillit, edhe nëse nuk parashihet shprehimisht nga dispozitat e këtij kodi, apo në kodet, ligjet ose në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore por që ka efekt të ngjashëm konsiderohen shkelje dhe për rrjedhojë sanksionohen;
2. Gjatë të gjithë kohës, anëtari i Këshillit do të veprojë në atë mënyrë që të nxisë besimin e publikut në dinjitetin, integritetin, efektivitetin dhe paanshmërinë e Këshillit.
3. Anëtari i Këshillit:
 - a) Respekton standarde të larta të sjelljes profesionale dhe personale,
 - b) Respekton dhe i përmbahet ligjit,
 - c) Kryen detyrat e Këshillit me paanshmëri dhe kujdes,
 - d) Shmangë çdo sjellje apo situatë që mund të vërë në pikëpyetje integritetin apo paanshmërinë e Këshillit,
 - e) Kryen detyrat sipas standardeve dhe parimeve ndërkombëtarisht të njohura për të drejtat e njeriut,
 - f) Mbanë interesin e publikut si bazë për veprim, dhe
 - g) Nxitë këto parime gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të tij/saj.
4. Dispozitat e sipërme vlejné jo vetëm për aktivitetet profesionale të anëtarëve të Këshillit, por edhe për jetën private të tij/saj (apo ndoshta për jetën tjetër profesionale), kur veprimet e anëtarit të Këshillit dëmtojnë imazhin e Këshillit në syrin publik, e kështu ndikon tërë institucionin.

5. Anëtari i Këshillit nuk përfshihet në asnjë veprimtari, përfshirë veprimtari politike, që është e papajtueshme me funksionet e tij/saj.
6. Anëtari i Këshillit nuk ka funksion në, apo të jetë anëtar, i asnjë partie politike, me përjashtim të Ministrit të Drejtësisë. Anëtari i Këshillit që është edhe prokuror i shtetit, nuk mund të ketë funksion në, apo të jetë anëtar, i asnjë partie politike.
7. Anëtari i Këshillit ka për detyrë që të veprojë në mirëbesim gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave, duke respektuar faktet dhe procedurat në pajtim me ligjet e aplikueshme dhe aktet nënligjore.
8. Sjellja e duhur etike dhe perceptimit i sjelljes së duhur etike, janë esenciale në kryerjen e të gjitha aktiviteteve të një anëtari të Këshillit Prokurorial.
9. Në pajtim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, anëtarëve të institucionit prokurorial u garantohej liria e shprehjes, besimit, mbledhjes dhe organizimit si çdo qytetari tjetër, megjithatë, gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, anëtari i një Këshilli Prokurorial duhet gjithmonë të sillet në atë mënyrë që të mbrojë dinjitetin e zyrës së tij/saj, si dhe paanësinë dhe pavarësinë e institucionit prokurorial.

Neni 3 Rregullat dhe aktivitetet specifike të etikës

1. Anëtari i Këshillit ruan dhe përmirëson standardet më të larta të profesionalizmit dhe ekspertizës ligjore dhe për këtë qëllim, angazhohet në arsimimin dhe trajnime të vazhdueshme ligjore kur është e mundshme.
2. Në veçanti, anëtari i Këshillit respekton dhe zbaton:
 - a) Parimet etike të funksionit të përshkruar në këtë Kod të Mirësjelljes,
 - b) Të drejtën e palëve të angazhuara në procedurë para Këshillit,
 - c) Të drejtat dhe liritë e pranuar ndërkombëtarisht,
 - d) Parimet dhe praktikat e organizimit të punës, menaxhimit dhe burimeve njerëzore në kontekst prokurorial dhe gjyqësor.
3. Anëtari i Këshillit do të ketë dijeni për:
 - a) Mekanizmat dhe materialet në dispozicion që kontribuojnë në vijimësinë e veprimtarive të tij/saj; dhe
 - b) Kornizën ligjore dhe kushtet e punës në të cilin prokuroritë ushtrojnë funksionet e tij/saj.
4. Anëtari i Këshillit mbanë përgjegjësinë për të shmangur konfliktin e interesave në bazë të marrëdhënieve familjare dhe shoqërore në pajtim me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave.
5. Në çdo rast, nëse anëtari i Këshillit mëson për ndonjë konflikt interesi apo për çfarëdo rrethana të tjera që mund të ngrenë dyshime në lidhje me paanësinë e tij/saj, ai/ajo do i

ndërpret të gjitha veprimtaritë mbi rastin dhe menjëherë njofton Kryetarin e Këshillit me shkrim në lidhje me atë situatë.

6. Në çdo rast, nëse anëtari i Këshillit, e fshehtë, respektivisht nuk e raporton ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit apo çfarëdo rrethane tjetër që mund të ngrisë dyshime në lidhje me paanësinë e tij/saj, por ndonjëri nga anëtarët e Këshillit ka njohuri për këtë rrethanë, do të ishte e detyrueshme për këtë anëtarë që këtë rrethanë t'ia raportojë Kryetarit të Këshillit.

Anëtari i këshillit duhet të respektojë pavarësinë gjyqësore, ekzekutive dhe legislative, dhe në asnjë rrethanë nuk pengon apo ndikon pavarësinë e atyre instituicioneve. Ai/ajo në asnjë rrethanë nuk interpreton ndonjë vendim gjyqësor, nuk pengon ndonjë përmbarim të vendimit, apo kritikon Këshillin Prokurorial apo Gjyqësor.

7. Anëtari i këshillit promovon marrëdhënie profesionale dhe funksionale në mes të prokurorive, gjykatave dhe policisë dhe agjensive tjera të zbatimit të ligjit.

8. Në raportin e tij/saj me individë apo anëtarë të Këshillit, do të:

- a) zbatojë funksionet e tij/saj me drejtësi, paanshmëri dhe objektivitet;
- b) respektojë dhe kërkojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- c) shmangët nga diskriminimi mbi çfarëdo baze duke shmangur çdo sjellje diskriminuese ndaj çdonjërit person apo persona mbi çfarëdo baze, përfshirë gjininë, moshën, gjendjen martesore, gjuhën, paaftësinë mendore apo fizike, orientimin seksual, përkatësinë apo bindjen politike, origjinën etnike, kombësinë, fenë apo besimin, racën, origjinën shoqërore, të lindjes apo çdo status tjetër;
- d) sigurojë barazinë në procedurë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e ndryshme që ndikojnë procedurën dhe vendimin e drejtë.

9. Anëtari i Këshillit:

- a) Nuk inicion apo merr pjesë në ndonjë procedurë që nuk ka bazë ligjore;
- b) Nuk pranon si dëshmi në procedurë ndonjë informatë apo provë që nuk konsiderohet e vlefshme;
- c) Synon ruajtjen e parimit të barazisë së palëve duke u shpalosur informata palëve të ndryshme në procedurë, përveç nëse parashkruhet ndryshe me ligj, në veçanti nëse kjo ndikon rezultatin e drejtë të procedurës;
- d) Mbanë informatat konfidenciale të pranuar nga palët, përveç nëse kërkohet shpalosja e tyre në interes të drejtësisë apo me ligj;
- e) Merr parasysh interesat e individëve që marrin pjesë në procedurë para Këshillit;
- f) Shmangë ndikimin e padrejtë në punën e Këshillit.
- g) Ai/ajo dhe as familjarët e tij/saj, në asnjë rrethanë nuk do të pranojnë dhurata, favore, privilegje apo premtime për ndihmë materiale nga ndonjë person që ka interes të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë në procedurë para Këshillit.

Neni 4
Aktivitetet jashtë punës së Këshillit

1. Në parim, anëtari i Këshillit mund të kryej aktivitete jashtë mandatin të Këshillit, përfshirë ato veprimtari që janë mishërimi i të drejtave të tij/saj si qytetar apo që përfaqësojnë interesat e tij, ose pasqyrojnë pavarësinë e tij/saj.
2. Pavarësisht dispozitës nga paragrafi 1, anëtari i Këshillit nuk mund të kryej aktivitete që mund të ndikojnë negativisht reputacionin e Këshillit, apo besimin publik apo profesional nga komuniteti të Këshillit si institucion.
3. Anëtari i Këshillit mund:
 - a) të flasë, shkruajë, ligjëroj, jap mësim dhe të marrë pjesë në veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me ligjin, sistemin ligjor dhe me administrimin e drejtësisë, përfshirë angazhimin në këto veprimtari përmes agjencive qeveritare ose joqeveritare që i përkushtohen interesave të tilla; dhe
 - b) angazhohet në sporte, veprimtari çlodhëse dhe aktivitete tjera qytetare si dhe merr pjesë në veprimtari bamirëse.
4. Për dallim me statusin sipas detyrës zyrtare që ka Ministri i Drejtësisë, anëtari i Këshillit nuk do të:
 - a) angazhohet në asnjë veprimtari, përfshirë veprimtari politike, që është e papërrputhshme me funksionet e anëtarit të Këshillit;
 - b) mbanë mandat në cilëndo parti politike; ose
 - c) angazhohet në ndonjë aktivitet që komprometon funksionin e tij/saj si anëtar i Këshillit.
5. Anëtari i Këshillit duhet të mbajë komunikim të hapur dhe aktiv me mediat dhe publikun në pajtim me rregullat dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli.
6. Anëtari i Këshillit, në emër të Këshillit nuk kërkon fonde për vete, për ndonjë organizatë apo agjenci, nuk lejon që emri i tij/i saj të përdoret për të kërkuar fonde apo nuk lejon që prestigji i institucionit të Këshillit të përdoret për atë qëllim, përveç nëse lejohet nga rregullat dhe rregulloret e Këshillit.
7. Anëtari i Këshillit e ka të ndaluar të përdorë pozitën e tij/saj apo informatat e pranuar përmes pozitës së anëtarit të Këshillit për çfarëdo përfitimi personal ose për të mirë të dikujt tjetër.
8. Anëtarët e Këshillit nuk mund t'iu përkasin organizatave që mbështesin apo nxisin diskriminimin apo çdo lloj veprimtarie që nuk përputhet me funksionet e tij/saj si anëtar i Këshillit.
9. Anëtari i Këshillit duhet t'ia paraqesë Agjencisë Kosovare Anti-Korrupsion pasuritë e tij në pajtim me ligjin e aplikueshëm në fuqi.

Neni 5
Përgjegjësitë Administrative

1. Anëtari i Këshillit do të kujdeset për përgjegjësitë administrative të tij/saj me profesionalizëm dhe vëmendje dhe bashkëpunon me anëtarët tjerë të Këshillit dhe organet administrative të Këshillit.
2. Në veçanti, anëtari i Këshillit:
 - a) Respekton detyrimet e nevojshme që i përkasin funksionit të tij/saj si anëtar i Këshillit sa i përket mbikëqyrjes së stafit nën kontrollin apo mbikëqyrjen e tij/saj;
 - b) Organizon veprimtarinë e tij/saj dhe respekton detyrimet e posaçme të kohës dhe detyrës që janë të nevojshme për ushtrimin e funksionit të tij/saj.
 - c) Respekton rregullat dhe rregulloret, çdo udhëzim administrativ të nxjerrë nga Këshilli në lidhje me aktivitetet, pa lejuar komprometuar mandatin e vendimmarrjes së institucionit të Këshillit.
3. Në lidhje me organizimin dhe punën e brendshme të Këshillit, anëtari i Këshillit shmang çdo ndikim të papranueshëm dhe promovon punën e drejtë të sistemit të drejtësisë penale të Kosovës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 6

Koordinimi me kodet tjera të mirësjelljes.

1. Në rastin e kundërthënies në mes të dispozitave të këtij kodi të mirësjelljes dhe dispozitave të ndonjë kodi tjetër të mirësjelljes profesionale që vlen për anëtarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, mbizotëron ky kod.
2. Ky Kod mund të ndryshohet dhe plotësohet me Vendim të KPK-së.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar me datë 31 korrik 2012.



Ismet Kabashi
Ismet Kabashi
Kryetar Këshillit Prokurorial të Kosovës